

UDHËZIM
Nr. 645, datë 14.12.2015

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN E INFORMACIONIT DHE VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE E TË DEKLARIMEVE NGA VENDI I ORIGJINËS PËR AZILKËRKUESIN DHE REFUGJATIN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 121 dhe 124, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Drejtuesi i autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, cakton një specialist të këtij autoriteti, për verifikimin e të dhënave që mblidhen gjatë aplikimit dhe intervistimit për azil, në institucionet shtetërore, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me gjendjen e përgjithshme që mbizotëron në vendet e origjinës së azilkërkuesit dhe refugjatit dhe kur është e nevojshme, në vendet përmes të cilave ata kanë qenë transit.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, mund të kërkojë informacion pranë Drejtorisë për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të azilkërkuesit dhe të refugjatit. Drejtoria për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve sipas parashikimeve të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, mund të kërkojë informacion, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, brenda fushës së kompetencës së kësaj drejtorie, me qëllim verifikimin e deklarimeve të azilkërkuesit dhe refugjatit, për vendet përmes të cilave ata kanë qenë transit. Kjo drejtori, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune, për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve sipas parashikimeve të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, mund të kërkojë informacion pranë Shërbimit Informativ të Shtetit, me qëllim mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave dhe deklarimeve të azilkërkuesit dhe refugjatit. Shërbimit Informativ i Shtetit, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve sipas parashikimeve të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

5. Informacioni në përputhje me klasifikimin e tij, mund të kërkohet apo të jepet paraprakisht nëpërmjet postës elektronike zyrtare dhe më pas me shkresë zyrtare.

6. Informacioni i mbledhur administrohet në dosjen personale të azilkërkuesit dhe refugjatit.

7. Rregullat dhe procedura për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave dhe të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatin, të parashikuara në këtë udhëzim, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për personat që kanë përfituar statusin e mbrojtjes plotësuese dhe ata në mbrojtje të përkohshme.

8. Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 752, datë 9.12.2009, “Për marrjen e informacionit dhe verifikimin e deklarimeve, nga vendi i origjinës së azilkërkuesit”, revokohet.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri